

Drejtuar:

- **Prokuroria Themelore Publike – Strugë**
- **Prokuroria Themelore Publike – Shkup**

KALLËZIM PENAL

Nga: Qytetarë të Strugës – të besimit islam, të punësuar në kuadër të BFI-së, anëtarë të Myftinisë dhe juristë.

Kundër:

BASHKËSIA FETARE ISLAME e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, Njësia organizative Myftinia e BFI-së në RMV – Strugë. Përfaqësues i autorizuar: Adi Murtishi nga fshati Ladorishtë.

Për veprën penale:

- Shpërdorim të detyrës zyrtare dhe mosrespektim të Kushtetutës së BFI-së dhe Kushtetutës së RMV-së,
- Bazuar në nenin 29 të Kushtetutës së Bashkësisë Fetare Islame,
- Përçarje / Konflikt midis anëtarëve të Myftinisë, personelit të BFI-së dhe xhematit.

Ne, xhemati dhe një pjesë e anëtarëve të Myftinisë së qytetit të Strugës dhe rrethinës, kërkojmë respektimin e Kushtetutës së BFI-së dhe të Kushtetutës së RMV-së nga personat e autorizuar në Myftininë e Strugës.

Të gjitha vendimet e paligjshme të marra nga myftiu dhe ekipi i tij janë të papranueshme për ne.

Sipas nenit 29 të Kushtetutës së BFI-së:

**“Kryeimami emërohet nga Reisul-Ulema me propozim të Myftinisë.
Kryeimami duhet të ketë përfunduar arsim të lartë islam.”**

Shkelja e nenit 29 të Kushtetutës së BFI-së nga Myftiu Adi Murtishi, i cili ka zgjedhur Kryeimamin të qytetit të Strugës dhe rrethinës me vendim të njëanshëm, domethënë pa emërim zyrtar nga Reisul-Ulema dhe pa propozim nga anëtarët e Myftinisë.

Kryeimami është zgjedhur pa shpallje konkursi për vendin e punës, pa mendimin e anëtarëve të tjerë të Myftinisë dhe punonjësve të tjerë në kuadër të BFI-së. Nuk është diskutuar për kandidatët e mundshëm të kualifikuar për këtë pozitë dhe nuk është shqyrtuar nëse Abdulkadri Sheji është i kualifikuar për Imamin Kryesor.

Kërkesa jonë drejtuar organeve kompetente është që të ndërmerren masat e duhura për mosrespektimin e Kushtetutës së RMV-së dhe Kushtetutës së BFI-së, përkatësisht nenit 29 të Kushtetutës së BFI-së, i cili thekson:

“Kryeimami duhet të ketë përfunduar arsim të lartë islam.”

Ne, xhemati i Strugës dhe rrethinës, jemi të informuar edhe nga vetë Abdulkadri Sheji, i cili kryen funksionin e Kryeimamit, ai nuk ka përfunduar arsim të lartë islam (madje as arsim të lartë në përgjithësi), dhe si i tillë, sipas nenit 29 të Kushtetutës së BFI-së, nuk është i kualifikuar për këtë pozitë.

Ne kërkojmë nga Myftiu dhe Myftinia e Strugës përgjegjësi para organeve kompetente të BFI-së dhe institucioneve të drejtësisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut si dhe sqarim mbi bazë të cilave kritere Abdulkadri Sheji është shpallur Kryeimam.

Ne, xhemati, kërkojmë që personat e autorizuar të BFI-së si funksionarë fetarë të jenë shembull për respektimin e Kushtetutës së BFI-së dhe RMV-së, dhe që Myftinia e Strugës të jetë një institucion i drejtë, pa ndikime nga faktorë të jashtëm.

Në Myftininë e Strugës, Myftiu Adi Murtişi ka punësuar persona të pakualifikuar për pozitat e tyre, duke ndikuar negativisht tek xhemati, këshillat, anëtarët e Myftinisë dhe një pjesë e madhe e imamëve të Strugës dhe rrethinës. Kjo mënyrë e funksionimit ka krijuar hapësirë për konflikte dhe përçarje midis imamëve, duke dëmtuar unitetin e tyre dhe të këshillave të xhematit në Strugë.

Për mosrespektimin e Kushtetutës së RMV-së dhe Kushtetutës së BFI-së, përkatësisht për shkeljet e lartpërmendura, do të informohen edhe: Prokuroria Publike e Shkupit, Komisioni për Procedurë Disiplinore, Faktori Ndërkombëtar, Parlamenti i RMV-së, Ministria e Drejtësisë së RMV-së, Ambasada e SHBA-së, Misioni i OSBE-së, Bashkimi Evropian, dhe organet kompetente për shpërdorimin e funksionit.

Bashkangjitur:

Kopje e ankesës së parë, dëshmi nga statuset e publikuara në faqen zyrtare në Facebook të Myftinisë së Strugës, ku Abdulkadri Sheji paraqitet si Kryeimam.

SHËNIM:

E njëjta shkelje nga Myftinia e qytetit të Strugës është raportuar në BFI dhe në Prokurorinë Publike më 26.08.2024, por nuk janë ndërmarrë asnjë masë. Abdulkadri Sheji vazhdon të prezantohet si Kryeimam i qytetit të Strugës.

Strugë, 31.01.2025